



**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**I. Numër:463-01/46728,datë: 30. Qershor 2020.**

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të nenet 24 dhe 25 të Ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Ligji Nr. 06/L-092, si dhe nenit 36 të Statutit të Komunës së Pejës, 01. Nr. 09-8103 dt. 29.09.2008, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private te pronarit “Intern Investment Group” sh.p.k. nga Peja, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me dt. 30. Qershor 2020, muarr:

**V E N D I M**

**Nr. 29/2020**

**MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE ME PRONËN PRIVATE PËR REALIZIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN “QËNDRA, KAPESHNICA, DHE PUHOVCI” NË PEJË**

**I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e personit fizik, e më qellim të Rregullimit të rruges për Shtegun e ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” në Pejë .

**II.** Për realizimin e këtij këmbimi sipas këtij Vendimi është propozuar që të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore për këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës, për interes publik rregullimin e rrugës Shtegut të Ecjes buzë “Lumbardhit” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra, Kapeshnica dhe Karagaqi ” në Pejë, për realizimin e këtij interesi publik Pronarit privat “Intern Investment Group SH.P.K.” nga Peja për pronën private e cila gjendet në ngastrën 2959/1 në sipërfaqe prej 67 m<sup>2</sup> ZK Pejë me ½ dhe objektit individual për banim me etazhitet që gjendet në këtë ngastër propozohet këmbimi me pronën komunale një pjesë prej 191 m2 të ngastrës kadastrale 3443/2 PSH e KK Pejë ZK Pejë, ndërsa vlerësimin ligjor do ta bëjë Zyrtja për vlerësimin e paluajtshmerisë në kuadër të Ministrisë për Financa.

**III.** Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Komuna në afat prej pesë ditëve e paraqet kërkesën për vlerësimin e pronave të paluajtshme sipas pikës II të këtij vendimi Zyrës për Vlerësimin e pronës së Paluajtshme pran Departamentit të Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave.

**IV.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Dr.Islam Husaj**

**Vendimi ti dërgohet:**

1x1 MAPL-së

1x1 Kryetarit të Komunës

1x1 DÇPJ

1x1 Arkivë.

